STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 6 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (KUOMO) MIREPRET POTHUAJSE 200 MILIONE DOLLARE NE FONDE FEDERALE PER AUTORITETIN METROPOLITAN TE TRANSPORTIT (METROPOLITAN TRANSPORTATION AUTHORITY) PER RIMEKEMBJEN NGA SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) sot mirëpriti njoftimin e pothuajse 200 milionë dollarë në fonde federale nga Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) (FTA) dhe Agjencia Federale e Administrimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA) për të ndihmuar Autoritetin Metropolitan të Transportit (Metropolitan Transportation Authority) (MTA) për rimëkëmbjen nga super stuhia Sendi (Sandy). Fonde gjithsej 193.1 milionë dollarë përfshijnë rimbursimin fillestar nga FTA për kostot e pësuara nga Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit), Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island Rail Road) dhe Hekurudha e Metrosë së Veriut (Metro-North Railroad) gjatë përgatitjes për stuhinë deri në 29 janar. Financimi përfshin gjithashtu miliona dollarë për të rindërtuar urat dhe tunelet e MTA-së dhe mjediset e tjera të ndryshme. Ky është raundi i parë i fondeve që MTA ka marë për të ndihmuar në rimëkëmbjen nga Sendi (Sandy) dhe për t'u rindërtuar më e fortë.

141.6 milionë dollarë për Tranzitin e Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit)

MTA ka siguruar 141.6 milionë dollarë në financim thelbësor nga Programi i ri i Ndihmës për Emergjencat të Transportit Publik (Public Transportation Emergency Relief Program) i Administratës Federale të Tranzitit (Federal Transit Administration) për të ndihmuar në riparimin, rindërtimin dhe zëvendësimin e pajisjeve dhe mjediseve të Tranzitit të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit) të MTA-së që u dëmtuan rëndë.

Fondet do të mbulojnë kostot që kanë lidhje me përgatitjet përpara stuhisë të metrosë, sistemit të autobusave dhe Hekurudhës së Stejtën Ajlënd (Staten Island Railway) si vendosjen e qeseve të rërës, mbulimin e hapësirave të ajrimit dhe pastrimin e ullukëve. Fondet e FTA-së gjithashtu do të paguajnë për punën fillestare të kapitalit dhe riparimet e nevojshme në Kantierin e Koni Ajlënd (Coney Island Yard), që u përmbyt rëndë si rezultat i stuhisë. Motorrë të rinj të çelësave duhet të instalohen dhe 30 çelësa të shinave duhet të provohen dhe të rifuten në shërbim. Fondet do të mbulojnë gjithashtu kostot dhe vënien në zbatim të një "ure me autobuza" që siguroi shërbime të transportit për udhëtarët ndërmjet anës lindore të Manhatanit (Manhattan) dhe tre stacioneve të metrosë së Bruklinit (Brooklyn) më 1 dhe 2 nëntor. Fondet do të mbulojnë gjithashtu sferën fillestare dhe përpjekjet e hartimit të punës

shtesë të restaurimit, përfshirë punën në tunelet nën lumë, zëvendësimin e ndërlidhjeve të sinjalit dhe riparimin e pajisjeve të linjës, si stacione të ventilatorëve dhe dhomat e pompimit. Kjo punë, e cila është pjesë e një programi më të madh të riparimit të kapitalit është e nevojshme për t'u rimëkëmbur plotësisht nga super stuhia Sendi (Sandy), do të kërkojë angazhime të tjera financiare në të ardhmen.

"Këta dollarë federalë do të ndihmojnë në mbulimin e kostove të përgatitjeve përpara stuhisë dhe punës fillestare të rimëkëmbjes që bëri të mundur që MTA të rivendoste shërbimin sa më shpejt që ishte e mundur pas stuhisë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Veprimi i shpejtë i FTA-së do të ndihmojë në rindërtimin e infrastrukturës sonë të dëmtuar të tranzitit dhe në rivendosjen e shërbimit të plotë për miliona udhëtarë që i besojnë MTA-së çdo ditë."

"Përpara fillimit të Sendit (Sandy), qëllimi ynë ishte të rikthenim shërbimin sa më shpejt dhe me sa më shumë siguri që të ishte e mundur dhe ishim në gjendje t'a bënim atë. Këto fonde federale do të shërbejnë mjaft për të ndihmuar që MTA të paguajë për kostot fillestare të lidhura me atë përpjekje," tha Drejtori Ekzekutiv i Përkohëshëm i MTA-së Tomas F. Prendergast (Thomas F. Prendergast). "Por mbetet mjaft punë dhe do të vazhdojmë të punojmë në serinë tjetër të përmirësimeve, duke lidhur kontrata për projekte që janë thelbësore për udhëtarët tanë, përfshirë rivendosjen e plotë të shërbimit në Rokëuejs (Rockaways) dhe stacionin e tragetit në jug (South Ferry)."

17.9 milionë dollarë për të restauruar një linjë të metrosë në Rokëuejs (Rockaways)

141.6 milionë dollarë fonde për Tranzitin e Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit) përfshijnë 17.9 milionë dollarë për punën fillestare për të restauruar linjën e metrosë A të dëmtuar rëndë në Rokëuejs (Rockaways), pjesë të së cilës i mori uji gjatë Sendit (Sandy). Sendi (Sandy) dëmtoi 3.6 milje të linjës A ndërmjet Hauard Biç (Howard Beach) dhe pjesës Rokëuejs (Rockaways) të Kuins (Queens), ndërsa vërshimi i valëve mori me vete gardhet dhe shtratin prej gurësh, hodhi tonelata mbeturinash në shina dhe platforma, shkuli kabllo dhe e la të gjithë sistemin e sinjaleve nën ujë. Linja A pritet të rihapet në verën e 2013-tës.

"Shkatërrimi në Rokëuejs (Rockaways) ka detyruar më shumë se 30,000 udhëtarë të përditëshëm të metrosë që të gjejnë mënyra të tjera për të udhëtuar dhe sa më shpejt që të mund t'u rikthejmë trenin A aq më mirë do të jenë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Duhet të jemi mirënjohës për përpjekjet e Sekretarit të Transportit Rei Lahud (Ray LaHood) dhe Administratorit të FTA-së Pitër Rogof (Peter Rogoff) për fillimin e vales së fondeve thelbësore për të riparuar këtë dhe sisteme të tjera të rëndësishme të transportit të dëmtuara nga Sendi (Sandy)."

20.9 milionë për Hekurudhën e Long Ajlënd (Long Island Rail Road)

MTA-së i janë dhënë 20.9 milionë dollarë nga Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) për të rimbursuar MTA Hekurudhën e Long Ajlënd (Long Island Rail Road) për kostot fillestare të përgatitjes për dhe rimëkëmbjen nga Sendi (Sandy). Gjatë Sendit (Sandy), LIRR pezulloi shërbimin, lëvizi mbi 1,000 vagona në zona të ngritura, siguroi qindra kalime të gradave mbi 700 milje të shinave dhe mbrojti pasurinë në nivele të ulta nga përmbytja. Pasi kaloi stuhia, skuadrat e LIRR-it

punuan pa pushim për të pastruar më shumë se 600 pemë dhe shtylla të shërbimeve, varka dhe mbeturina të tjera nga shinat; për të restauruar shinat që i kishte marë uji dhe për të riparuar shinat e treta, çelësat dhe sinjalet; dhe për të riparuar më shumë se 200 nënstacione elektrike të përmbytura dhe të dëmtuara nga stuhia. Shërbimi i parë i kufizuar u rivendos dy ditë pasi goditi Sendi (Sandy). LIRR është duke punuar me FTA-në për të ndjekur rimbursimin për dëmtimin më të rëndë të infrastrukturës të shkaktuar nga stuhia, që ndodhi kur uji me kripë gërryese përmbyti tunelet e Lumit Lindor (East River), Kantierin e Anës Perëndimore (West Side Yard), Kantierin e Qytetit të Long Ajlënd (Long Island City Yard) dhe Degën e Long Biç (Long Beach Branch).

"Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island Rail Road) ndërmori hapa të jashtëzakonshme për të ruajtur pajisjet e saj nga dëmtimi përpara stuhisë, për të vlerësuar dëmin ndërsa stuhia kaloi përmes Long Ajlënd (Lond Island) dhe për të filluar rivendosjen e shërbimit të trenit vetëm dy ditë më vonë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "FTA ka filluar punën e rëndësishme të dhënies së fondeve federale për të rimbursuar LIRR për përpjekjet thelbësore të saj."

"Ky financim është i rëndësishëm për të ndihmuar që LIRR të rimëkëmbet financiarisht nga disa prej kostove nga Sendi (Sandy)," tha Prendergast. "Jemi duke ndjekur çdo dollar në dispozicion për të rimbursuar LIIR-in për kostot lidhur me Sendin (Sandy). Falënderojmë Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen e tij në këtë çështje."

14.9 milionë dollarë për Hekurudhën e Metrosë së Veriut (Metro-North Railroad)

MTA do të marë 14.9 milionë dollarë nga Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) për të filluar rimbursimin për MTA Hekurudhën e Metrosë së Veriut (Metro-North Railroad) për kostot e përgatitjes, reagimit të emergjencës dhe rivendosjes së shërbimit nga super stuhia Sendi (Sandy). Rreth 2.7 milionë dollarë të financimit është caktuar për pjesën e Konektikatit (Connecticut) të Linjës Nju Hevën të Metrosë së Veriut (Metro-North's New Haven). Programi i Ndihmës për Emergjencat të Transportit Publik (Public Transportation Emergency Relief Program) i FTA-së do të mbulojë 11.2 milionë dollarë të kostove të funksionimit që Metroja e Veriut (Metro-North) pësoi për përgatitjet për stuhinë, bërjen e riparimeve të menjëhershme dhe rivendosjen e shërbimit. Fondet federale rimbursojmë Metronë e Veriut (Metro-North) për lëvizjen e pajisjeve në vendndodhje të sigurta, mbushjen dhe vendosjen e qeseve të rërës, provat e funksionimit dhe trenat e patrullës, pastrimin e vagonave për rivendosjen e shërbimit, vlerësimin e kushteve të sigurisë dhe të mjedisit dhe dhënien e informacionit të azhornuar për udhëtarët gjatë gjithë stuhisë dhe pas saj. Fondet e FTA-së gjithashtu përfshijnë 3 milionë dollarë të tjera për të riparuar 17 vagona të hekurudhës dhe shtatë lokomotiva të dëmtuara nga ujrat e përmbytjes si dhe 720,000 dollarë për të hequr pemë të rëna, të dëmtuara ose të rrezikshme që janë në afërsi të infrastrukturës së rëndësishme përgjatë miljeve të shinave. Metroja e Veriut (Metro-North) është duke punuar me FTA për të ndjekur rimbursimin për investimet afat-gjata të kapitalit të nevojshme për të rikthyer infrastrukturën e Linjës Hadson (Hudson) në kushtet përpara stuhisë, si rivendosjen e vijës bregdetare dhe shinave si dhe infrastrukturën e energjisë, sinjaleve dhe komunikacioneve.

“Metroja e Veriut (Metro-North) është hekurudha më e madhe e udhëtarëve në Amerikë dhe veprimet e saj për të mbrojtur flotën e saj dhe për të rivendosur shërbimin pas stuhisë më shkatërrimtare në historinë e saj ishin vendimtare për rimëkëmbjen e Nju Jorkut (New York) nga stuhia,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Këto fonde federale janë të rëndësishme për të rifilluar rimbursimin e hekurudhës për kostot e konsiderueshme që pësoi gjatë gjithë asaj pune.”

“Ky rimbursim vlerëson përpjekjen e stërmadhe të kryer nga punonjësit e Metrosë së Veriut (Metro-North) që punuan pa pushim për t’u përgatitur për stuhinë dhe për të mbrojtur hekurudhën,” tha Prendergast. “Jemi të kënaqur që FTA ka vepruar kaq shpejt për të filluar rikthimet tek hekurudha për përpjekjet e saj.”

3 milionë dollarë për ura dhe tunele

MTA do të marë 3 milionë dollarë në fonde të përshpejtuara nga Agjencia Federale e Administrimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) për punën në shtatë urat dhe dy tunelet e saj. Rreth 2.7 milionë të fondeve të FEMA-s do të shkojnë drejt kostove të lidhura me heqjen e ujit nga tunelet Hju L. Keri (Hugh L. Carey) (ish-Bruklin Bateri (Brooklyn-Battery)) dhe Kuins Midtaun (Queens Midtown), që u përmbytën bashkërisht me rreth 72 milionë gallona të ujit të ndotur, me naftë kur Sendi (Sandy) goditi në 29 tetor. Pjesa e mbetur prej 351,611 dollarë do të mbulojë kostot e lidhura me shtyllat e dritave, shenjat, pemët e rrëzuara dhe dëmin ndaj ndërtesave të shërbimit dhe infrastrukturës së mbledhjes së tarifave anembanë nëntë mjediseve. Urat dhe Tunelet (Bridges and Tunnels) e MTA-së është duke punuar me FEMA-n për të ndjekur rimbursimin për pjesën e mbetur të kostove të saj të emergjencës pas Sendit (Sandy), si dhe të kostove të lidhura me riparime të përherëshme. Në Tunelin Hju L. Keri (Hugh L. Carey) dhe Tunelin Kuins Midtaun (Queens Midtown) një pjesë e punës së përkohëshme ende duhet të përfundojë ose ka përfunduar, por nuk është financuar ende.

“E pamë sesi vuajti Nju Jorku (New York) kur të dy tunelet Hju L. Keri (Hugh L. Carey) dhe Kuins Midtaun (Queens Midtown) ishin jashtë pune pas Sendit (Sandy) dhe e pamë punën e madhe që bënë Urat dhe Tunelet (Bridges and Tunnels) e MTA-së për t’i rihapur ato përsëri,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Puna është larg të përfunduarit, megjithatë. Këto para përfaqësojnë një angazhim të parë, të rëndësishëm nga FEMA dhe do të ndihmojnë të sigurojnë se këto lidhje vendimtare të transportit janë rivendosur plotësisht.”

“Jemi mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme të guvernatorit për t’i rikthyer këto dy lidhje të transportit në kushtet që ishin përpara Sendit (Sandy),” tha Prendergast. “Këta tunele u shkatërruan nga dyshemeja tek tavani dhe nuk është një arritje e vogël për t’u përpjekur që të bëhen këto riparime të ndërlikura dhe që kërkojnë kohë ndërsa vazhdojmë të transportojmë mesatarisht 119,000 automjete përmes tyre çdo ditë.”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian